



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË

Numri i lëndës: 2021:253290

Datë: 18.07.2024

Numri i dokumentit: 05954103

C.nr.337/2021

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Dega në Kamenicë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtarja Valbonë Dërvodeli, me bashkëpunëtorin profesional Blerand Sopi, në çështjen kontestimore të paditëses L. S. nga të cilën me autorizim e përfaqëson Elvira Haziri avokate në Gjilan, kundër të paditurit A. Z. nga me objekt vërtetimi i pasurisë së fituar në bashkësi martesore, me vlerë kontesti 5,000.00 Euro, pas shqyrtimit paraprak të padisë, më datë 18.07.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

NË BAZË TË HEQJES DORË NGA KËRKESËPADIA

I. REFUZOHET si e pa bazuar kërkesëpadia e paditëses L. S. nga, kundër të paditurit A.Z. nga, me të cilën ka kërkuar vërtetimin e të drejtës së pronësisë në pjesë ideale $\frac{1}{4}$ si dhe kompenzimi për pjesën sa e njehta ka kontribuar gjatë bashkësisë martesore të përbashkët.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta.

A r s y e t i m

Paditësja përmes të autorizuarës së saj, në këtë gjykatë me datë 09.11.2021, ka parashtruar padi kundër të paditurit, me kërkesë si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

E autorizuar e paditëses me parashtrësën e datës 10.07.2024, ka dorëzuar parashtrësë në këtë gjykatë, me të cilën parashtrësë ka tërhequr padinë dhe kërkesëpadinë, dhe në të cilën ka theksuar se, pas pranimit të ftesës nga kjo gjykatë, ka kontaktuar me paditësen, dhe nga e njëjta është njoftuar se ka krijuar familje të re, dhe jetë të re dhe se nuk ka më interes juridik të

vazhdoj me këtë çështje, andaj edhe kërkon ta mbyll këtë proces gjyqësor, në mungesë të interesit.

Gjykata, pas heqjes dorë nga kërkesëpadia nga ana e paditëses, ka konstatuar se kërkesa është e disponueshme për palët, prandaj, në kuptim të nenit 149, paragrafit 1 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK-së), me të cilin përcaktohet se *“në qoftë se paditësi deri në përfundimin e seancës për shqyrtim kryesor të çështjes heqë dorë nga një pjesë e kërkesëpadisë apo nga e gjithë kërkesëpadia, gjykata pa shqyrtim të mëtejshëm e jep aktgjykimin me të cilin e refuzon kërkesëpadinë në pjesën nga e cila paditësi ka hequr dorë apo në tërësi (aktgjykimi në bazë të heqjes dorë)”* pa shqyrtim të mëtejshëm, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi duke u bazuar në nenin 450 të LPK-së që secila palë t'i bartë shpenzimet e procedurës kontestimore.

**GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2021:253290, 18.07.2024**

**Gjyqtarja,
Valbonë Dërvodeli,d.v.**

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, ne afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit ne Prishtinë.